

**UNITED
NATIONS**

United Nations
Interim
Administration
Mission
in Kosovo



UNMIK

NATIONS UNIES

Mission
d'Administration
Intérimaire des
Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

Ligjislatura e dytë

*Komisioni për Shëndetës, Punë
dhe Mirëqenie Sociale
Nr. 25/2007*

PROCESVERBAL

*i mbledhjes së Komisionit për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, të mbajtur më
18. 9. 2007, në sallën N-225, në orën 11.00*

Të pranishëm: Fatmire Mulhaxha- Kollçaku, kryetare: Shpresa Murati, Nafije Berisha, Ilaz Pireva, Zylfije Hundozi, Rudina Bukoshi, Flora Brovina, Fehmi Vula, Zahrije Jusufi Ferid Agani dhe Zllatica Kujunxhiq, anëtarë.

Munguan : Naim Jerliu dhe Teuta Hadri .

Mbledhjen e drejtoi **Fatmire Mulhaxha – Kollçaku** dhe propozoi këtë:

REND DITE

- 1. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes se kaluar**
- 2. Shqyrtimi i Projektligji për barnat narkotike ,substancat psikotrope dhe prekursorë.**
- 3. Të ndryshme**

Rendi i ditës u miratua.

U hap shqyrtimi për pikën e parë

- 1 Miratimi i procesverbalit të mbledhjes se kaluar,**

Pasi nuk pati vërejtje, u miratua.

U hap shqyrtimi për pikën e dytë

2. Shqyrtimi i Projektligjit për barnat narkotike ,substancat psikotrope dhe prekursorë.

Fatmire Mulhaxha –Kollçaku, foli për rendësin e Projektligjit për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë dhe e ftoi raportuesin të marri fjalën .

Ferid Agani nënvizoi : Projektligjin për barnat narkotike, substancat psikotrope dhe prekursorë ka disa të meta të cilat janë të natyrës teknike ,por gjatë amendamtimit do t'i mënjanojmë . Projektligji i ofruar e mbulon fushën përkatëse .Vërejtje paraqiti në mos angazhimin e eksperteve të fushës se psikiatrisë dhe në përmbajtjeje të tij shihet mungesa e tyre. Gjithashtu, u diskutua çështja e parandalimi, përhapjes se narkomanisë ,trajtimi i tyre dhe brenda mundësive të komisioni do plotësojë vakumin me amendamente.

Flora Brovina ,duke ndërlidhur me parafolësit tha :Çdo ndërhyje ne Projektligj do të shkaktonte implikime buxhetore dhe se kërkoi paraprakisht të behet llogaritet kostoja buxhetore . Me mendimin e saj u pajtuan anëtarët.

Pra, në vija të trasha e raportuesi deri të neni 12 të projektligjit i njoftoi anëtare dhe mori qëndrim të vazhdohet me shqyrtimin në mbledhjen e radhës.

U hap shqyrtimi për pikën e dytë

2 Të ndryshme

a) Komisioni e shqyrtoi shkaqet e mos votimit të Projektligji i ushqimit nga deputetët dhe si ndodhi të mbetet për shqyrtimin e tretë .

Lidhur me këtë pikë u hap debat dhe ishte konstatim diskutuesve se veprimi i marrë nuk kërkon me rregullat e Rregullores se punës se Kuvendit . Prandaj , është dashtë raportet e dy komisioneve të hidhen ne votim se ishin funksionale. Gjithashtu u dhënë vërejtje se shkresa e kryeministrit nuk i bashkëngjitet raportit . Shkresa e shpreh qëndrimin e kryeministrit lidhur me formimin e Agjensionit për ushqimin dhe lidhur me këtë u nxori këtë ;

P e r f u n d i m

Komisioni e autorizoi kryetaren ta njoftoi për se afërmi kryetarin e Kuvendit të Kosovës lidhur me Projektligjin e ushqimit .

b) kryetarja ngriti çështjen e projektligjeve të pa përfunduara dhe kërkoi nga anëtarët në përshpejtimin e shqyrtimit dhe procedimit për miratim të projektligjeve.

Mbledhja përfundoi në orën 13,40

Procesmbajtës,
Rrahim Demaj – zyrtar i lartë ligjor

**Kryetarja e Komisionit
Fatmire Mulhaxha- Kollçaku**